



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 42-060-69601 dt. 06.12 2019

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 15.11.2019, ora 10⁰⁰.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi.

Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin, Kryesuesi i Komunës Labinot Halilaj, Drejtoria për SHMS; - zyrtarja Lumturi Kiçina, nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë; zyrtari Ruzhdi Lestrani si dhe përfaqësuesi i OSBE-së Driton Nuli

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 22.10.2019.
2. Propozim Vendim për ndryshimin e periudhës së zbatimit të PLVM-së për vitet 2020-2024.
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2020-2024
4. Propozim Vendim lejohet vazhdimi i kontratave me qira jo profitabile mbi dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të banesave sociale në Bllokun e banimit I dhe II-të në Drenasin III.
5. Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Komoran për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit.
6. Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Sankoc për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit.
7. Propozim Vendim për harmonizimin dhe transferimin e mjeteve për paga.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Nga ekzekutivi kemi dhe një pikë të rendit të ditës: Propozim Vendimi për harmonizimin dhe transferimin e mjeteve për paga. Besoj a jeni për këtë rend të ditës. Atëherë, pasi nuk ka diskutime, vërejtje, apo sugjerime kalojmë në aprovimin e Rendit të ditës.

Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet.

Kalojmë tek Pika e parë; Proces verbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 22.10.2019.

E hapim për diskutim. Meqë nuk ka diskutime kalojmë në votim.

Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Pika 2; Propozim Vendim për ndryshimin e periudhës së zbatimit të PLVM-së për vitet 2020-2024.

Hapim diskutimet. Ka diçka po Burim Bujupi pse ma herët nuk na kanë sjell Propozim Vendim se si propozim na ka ardhë me 2019-2024 , Vehbi Berisha e ka kthye mbrapsht, ka kërkuar me e ndrysh propozim vendimin me ba 2020-2024,se Kryetari me anëtarët e vetë e ka ba gabim.

Kryesuesi: Zëri nuk dëgjohet..., Herë pas here dëgjohe vetëm komentet e shkurtra të kryesuesit të kuvendit...

Kryesuesi; Burim unë mendoj që gjithmonë me opozitën kemi pasur bashkëpunim dhe po thuajse në ë gjitha debatet kemi pasur propozimet e opozitës lidhur me taksat dhe janë inkorporuar pothuajse të gjitha propozimet tuaja, bilës ka pasur më shumë propozime nga ju, opozita, sesa nga pozita. Këto janë të dëshmuara në incizime janë edhe në procesverbale. Mendoj se në këtë rast ka pas tendencë ose ka tendencë ndaj asambleistit Berisha në kuptimin e mospërfilljes të propozimit të tij lidhur me ndryshimet. Ndoshta me diskutimet në kuvend do të kemi një qëndrim më të qëndrueshëm edhe nga ana e ekzekutivit... zëri nuk dëgjohet më tej për procedurën e votimit.

Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Pika 3; Propozim Vendim për miratimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2020-2024.

Hapim pikën e tretë për diskutim. Nuk dëgjohet asgjë rreth pikës 3... vetëm në fund fjalë e kryesuesit; kërkojmë që të rekomandohet për diskutim në Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj:Votojmë; 7 për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Miratohet

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Kalojm tek Pika 4; Propozim Vendim lejohet vazhdimi i kontratave me qira jo profitabile mbi dhëniën në shfrytëzim të përkohshëm të banesave sociale në Bllokun e banimit I dhe II-të në Drenasin III.

Fjalën e merr zyrtarja e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale Lumturie Kiçina; jemi shtatë anëtar në komision kemi bërë verifikimin në teren, për aplikim kanë qenë kriteret e caktuara.

...zëri nuk dëgjohet...

Burim Bujupi ... Mirë është kenë, me ditë me çfarë poenash e keni ba, nuk keni bërë verifikim dhe nuk dimë çfarë metode keni aplikua, por keni marrë gjendjen sociale të tyre,. Ju po thoni...vetë po bini në konflikt me vetveten. Po thonë që kemi bisedu me 7 a 8 anëtarë familjes ndërsa këtu janë shumë më shumë. Dmth. Që nuk keni bërë verifikim as për shumicën, 42 janë deri këtu plus janë edhe do të tjerë... nuk është ditë me gojëdhëna.. E tjetra. Qysh mundesh ti me ia dhënë. Me çfarë arsytimi mundesh me ia dhënë banesë Hava Deliut kur ajo është me kurorëzim, po thoni që burrin e ka jashtë vendit. Ne e dimë se kur shkon jashtë vendit shkon për mundësi punësimi, mund të ndodh që ti ketë kushtet e mira dhe nëse kthehet ai mund të thotë çka pse? Ju jeni në konflikt me të. Ju po i hapni punë vetes... Ata vazhdojnë të jetojnë aty. Unë mendoj të kthehet mbrapsht. Mu bë verifikimi edhe njëherë, mu nda me një arsyetim më të mirë dhe me na ardh në komitet financave dhe me aprovua edhe njëherë.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Kjo është gjendje momentale e familjes, çfarë ju po paragjykoni për nesër, kjo është relative, nuk mund ta përcaktojë as komisioni as drejtorja. Nëse sot psh. familja deklarohet që s'janë çift bashkëshortor ai mund me shkrua gjithçka nëse nuk kthehet kurrë ... kjo hipotetikë është.

Lumturie Kiçina; Bashkohem me parafolësin. Kjo nuk më duket shumë profesionale. Komisioni ... më vjen keq po lë hapësirë për shumë dyshime. Mua po më duket se na zakonisht po i kryejmë punët hajt veç mos i prishim punë kujt... Këtu po i shohim disa persona fatmirësish

vend i vogël dhe deshëm apo s'deshëm ne njihemi me njeri – tjetrin dhe këto janë disa persona që dihet se nuk e kanë gjendjen aq të keqe dhe të vështirë ekonomike, qoftë shëndetësore apo familjare që me marrë në shfrytëzim banesa komunale, përderisa e dimë që kemi shumë raste të reja, të cilat e kanë gjendjen shumë të vështirë ekonomike dhe mund tu ndihmojmë atyre. Përderisa nuk kanë dokumentacion unë mendoj se duhet bërë presion ta sigurojnë dokumentacionin dhe ti ndihmojmë me një banesë. Kemi shumë raste të tjera që janë nëna vetë ushqyese dhe duhet tu japim përparësi dhe mu ba zgjidhje e jo këtu që po shohim njerëz që janë në punë. Përderisa nuk ka të dhëna të sakta, mund të ketë familje që kanë të ardhura të mira por nuk duan te shpenzojnë duke përfutur nga banesat komunale. Edhe unë mendoj se kjo punë duhet kthyer mbrapsht dhe t'ia fillojmë edhe njëherë nga fillimi, pasi kështu totalisht po më duket e dyshimtë. Unë po them më parë u kishim dhënë përparësi nënave ushqyese pasi gratë nuk kanë shumë hapësirë për punësim dhe kur janë me fëmijë e kanë shumë e më shumë të vështirë.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Vetë më herë keni deklaruar se skeni mujt me bë verifikime, e keni bërë veç në 7-8 familje. Në e keni bërë në 7-8 familje në përqindje me numrin e banesave që ju doni me japë me ia vazhdu kontratat dhe disa doni me ua dhënë disa të rinjve i bie diku 15%. Kështu me një përqindje kaq të ulët ne nuk guxojna me votu... **zëri nuk dëgjohet**

Lumturie Kiçina; Si po arsyetohet që nga BQK ka persona që janë me dy rroga dhe u jepet banesë komunale. Për mua kjo është e papranueshme.

Për mendimin tem duhet të kthehet mbrapsht.

Është e tmerrshme me përfutu në këtë mënyrë me banesat e shtetit, duke marrë banesa të komunës e mos me pagu hiç. ... **zëri nuk dëgjohet...**

Më vjen keq po do doja që edhe kolegët në asamble të reagojnë dhe ta kthejnë mbrapsht këtë, përndryshe opozita edhe protesta kisha propozu me organizu.

Përfundimisht unë mendoj të kthehet mbrapsht... **zëri nuk dëgjohet...** Të bëhet informimi, te gjenden rrugët ndërmjet asambleistave apo diçka tjetër. Web faqja e Kuvendi nuk mjafton duke ditur që komuna është e varfër dhe ka shumë familje të varfra që janë pa shkollë nuk dalin për shkak të varfërisë etj. ... **zëri nuk dëgjohet...**

Unë mendoj se ne asambleistat duhet të dalim shpi më shpi për ti informu sepse njoftimi vetëm në Web faqen e komunës më duket! Nuk jemi ai popull që rimë në web faqen e komunës për tu informu. Por ne duhet të gjejmë organizma se si me informu.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: Jo jo. po flas për drejtorinë dhe komunën. Në këtë rast e nderuara përfaqëson edhe drejtorinë edhe komunën, Nuk mundesh përveç asaj zyrtares çfarë të jepet ty me ba informim tjetër. Nuk është në domenin e komunës për të informuar administratorë për çdo informim... **zëri nuk dëgjohet...**

Sa për informim mos të mendojmë të abuzojmë sepse komuna e ka bërë informimin në Web faqen e saj, a nëse nuk do ta kishte bërë atëherë plotësisht pajtohem me ty që do rishikuar. Pastaj mos ta bëjmë gjendjen kaq tragjike se edhe ato raste sociale nuk është kaq i madh numri i familjeve. Nuk po them se janë në gjendje të mirë materiale, po nuk janë deri në atë masë sa të themi se kemi një numër të madh të rasteve sociale. Çështjen e banimit ndoshta e ka të zgjidh ndoshta nuk ka kushte të mira ekonomike por çështjen e banimit e ka zgjidh. Në këto raste është ajo që thatë ju nëse ka raste që janë dy familjarë që janë në marrëdhënie pune po nuk kanë mundësi me bë banim... **zëri humbet...**

Burim Bujupi; Unë mendoj që kjo pikë mos të dërgohet në kuvend të kthehet mbrapsht pasi materiali ka mangësi të mëdha dhe ka nevojë për vërejtje që materiali të mos sillet herë tjetër kështu pasi ka nevojë të studiohet më mirë dhe ky propozim vendim të vijë tamam i plotë dhe me kriteret të cilat janë dhënë gjendjen sociale për gjithë secilin, të hyrat familjare, të bëhet verifikimi i familjeve në vendbanimet e përhershme me një fjalë të plotësohet krejt dokumentacioni që ne të marrim një vendim të pjekur pasi është një çështje shumë e ndjeshme për shumë banorë. ...zëri humbet...

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; Atëherë ne propozojmë me shku në kuvend, për diskutim me vërejtje, kemi kohë një javë për me i shqyrtu...zëri ndërpritet dhe nuk dëgjohet për një kohë të gjatë debatet.

Kryesuesi; Faleminderit shumë me debatin për pikën 4. Unë propozoj për të kaluar kjo pikë shkojmë në votim; 3 për, 4 kundër, abstenim nuk ka.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; Pika 5. Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Komoran për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit. Po Burim fjala jote patjetër... zëri humbet...

Kryesuesi i Kuvendit; Burim ters e ke me këtë pikë. Duke pasur parasysh nevojat dhe kërkesat e mëdha për përmirësimin e kushteve dhe një zhvillim sa më të mirë të aktivitetit mortor dhe aktiviteteve të tjera për banorët e saj, lagjja Gruda, të fshatit Komoran, të Drenasit dmth kur ti ndërtosh këto shtëpija duhet me qenë zona e lirë... si me thënë a është e qartë? Të njëjta kërkesa më kanë ardhur edhe mua si kryesues i Kuvendit. Nuk është në domenin e zyrës tonë mi trajtu këto. Për këto duhet me iu drejtu ekzekutivit. Ata bëjnë matjet atje ku janë parcelat. Ata kanë kërku një hapsirë 4 ari ... zëri humbet...

Kryesuesi i Kuvendit; Faleminderit për pjesëmarrjen. Jemi tek pika 5. Koleg nuk je i qartë në sqarime dhe ka nevojë për rregullime dhe sqarime të mëtejshme te ngastra në Komoran 4 ari, për shfrytëzim për komunitetin. Ne e propozuam që është me kërkesë të qytetarëve ju e keni punuar dhe sqaruar, por ne kemi nevojë për sqarime shtesë. Burimit ia kisha kalu fjalën se ai e di ku është halli.

Burim Bujupi; Ne e kemi marrë këtë material por është i mangët dhe sqarimet shtesë duhen dhënë këtu. Për dhënien me afat të gjatë është mirë me na tregu me ligj, sa është afati me na tregu. Arsyetim tjetër është bashkë me ditë sa është kanotacioni se 4 ari... në bazë të numrit të parcelës ne nuk mund ta dimë faktikisht se ku është. Kjo tokë komunale a është e mundur mu shfrytëzu për tjetër gjë më të dobishme se bash për këtë punë. Nuk jena kundër po deshëm edhe arsyetimin. Jeni deklaruar në bazë të banorëve të fshatit, lagjes Gruda dhe jeni mbështetur në bazë të kërkesës së administratorit të fshatit Komoran 2, që realisht në Komoran administrator është tjetër person. Kështu është mirë të mund të na jepni sqarime procedurialisht për funksionimin e këtyre funksioneve të administratorëve komunalë. ...zëri humbet... vijon

Burim Bujupi. Faleminderit për arsyetimin. Por unë them kur janë lokacioni për varreza po shoh se aty po shkruan për raste mortore dhe gazmore që nuk shkojnë të dyja bashkë. Po seriozisht se ashtu është e shkruar. Ndaj duhet me ditë kufini midis këtyre lokacioneve, në pronësi të varrezave dhe duhet ditur kufini.

Kryesuesi i Kuvendit; Fjala për zotin Lestrani. Ruzhdi Lestrani,.. nuk dëgjohej asnjë fjalë e tij...

Kryesuesi i Kuvendit; Jo jo. Kur flitet për varreza përcaktohet kufini dhe ju tjetër lokacion po jepni. Faleminderit shumë kush është për me kalu kjo pikë. Faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit; Pika 6 Propozim Vendim për lëshimin në shfrytëzim afatgjatë të parcelës në ngastrën kadastrale në Sankoc për ndërtimin e një objekti në shfrytëzim nga ana e Komunitetit. Kjo pikë është e ngjashme me pikën 5 me kërkesë të komunitetit, por nuk është tek varrezat por tjetër vend. E spiejoj edhe këtë pjesën pa afat... normal ajo që për rastet mortore edhe kjo mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera. Atëherë a jeni që edhe kjo pikë të kalojë. Faleminderit shumë

Pika 7. Propozim Vendim për harmonizimin dhe transferimin e mjeteve për paga.

Fjalën e ka Drejtori i financave Shyqyri Bublaku: Duke u bazuar në Ligjin 06/L-133 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenit 12 pika 2 si dhe nenit 15 pika 6, ku lejohet harmonizimi dhe transferi në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve nga nenprogramet e të njëjtës OB, por duke mos e rritur numrin e të punësuarve dhe duke mos tejkaluar shumën e certifikuar më buxhet për kategorinë në fjalë.

Deri të mos mbulimi i kategorisë së pagave dhe mëditjeve në nenprogramin e Bujqësisë ka ardhur për shkak të alokimit të mëvonshëm për nenprogramin e ri Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik, të cilat mjete janë shpenzuar nga ky program, dhe nenprogramin Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor kemi aktivizimin e kujdesit 24 h në QMF-në në Komoran .

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj; Ne veç e diskutuam. Më shumë kemi terma, është harmonizim bartja më shumë është çështje teknike. Atëherë a jeni dakord që edhe kjo pikë të kalojë. Ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen në debate.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj;


Kalojmë tek pika e fundit; të ndryshme. Nuk ka diskutime atëherë mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Shënim; Ky transkripto ka shumë ndërprerje të gjata të zërit dhe shpesh nuk dëgjohej debatet. Jam munduar të hedh ato ku mendimet janë më të plota dhe shumicën i kamë plotësuar nga fletorja e procesverbalit.

Këto probleme kanë ndodhur për mungesën e zyrtarit të IT.

Mbledhja përfundoi në orën 11⁰⁰:59⁰⁰

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku- Subashi

